



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORË-HIMARË  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Nr. 426 Prot.

Vlorë, më 05 . 03 . 2024

### NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012. "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 100, datë 25.02.2022, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe në zbatim të shkresës nr. 5245 prot., datë 22.08.2023, "Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2023-2024", ju njoftojmë se:

Për vitin shkollor **2023-2024**, aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës e-albania. Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, **për periudhën e tretë mësimore është nga data 05.03.2024-15.03.2024** .

Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në periudhën e dytë, ngarkon në platformën online (e- Albania) dokumentet si më poshtë:

1. CV (jetëshkrimi) i aplikantit
2. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të parë (Bachelor)
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe/ose "Master profesional" në mësuesi
4. Raporti mjeko-ligjor

Shënim: Në mungesë të kartonit të diplomës së ciklit të dytë të studimeve, kandidati për praktikant duhet të pajiset nga fakulteti përkatës me një vërtetim ku të specifikohet që ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare me universitetin.

*Nëse kandidati i interesuar për zhvillimin e praktikës profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online dokumente, të cilat dyshohet se janë të falsifikuara , përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale. Rasti i referohet organeve kompetente.*

DREJTOR  
Gentiola SHEHU

